

Hezitimi ndaj vaksinave i prindërve apo kujdestarëve në Shqipëri: Njohuritë, qëndrimet dhe praktikat ndaj vaksinimit në fëmijëri

Enkeleda Gjini, Universiteti Katolik “Zonja e Këshillit të Mirë”, Tiranë

1. HYRJE

Imunizimi ka shpëtuar miliona jetë nëpërmjet mbrojtjes së individit dhe popullatave nga sëmundjet e parandalueshme prej vaksinave (SPV) (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2012). Shqetësimet publike rreth vaksinimit zënë fill që me shpikjen e vaksinave dhe nxiten nga informacionet e rreme të shpërndara me shpejtësi në botën e internetit, ku njerëzit kalojnë shumicën e kohës së tyre në ditët e sotme (Casara et al., 2019). Përhapja e fruthit në vitin 2018 tregoi se sistemi shëndetësor shqiptar vijon të hasë vështirësi për sigurimin e respektimit të praktikave të parandalimit dhe kontrollit të infeksioneve në kontekstin e kujdesit shëndetësor. Në një studim të kryer në vendet evropiane në vitin 2018, u konstatua një hezitim në rritje ndaj vaksinave, si te publiku, ashtu edhe te profesionistët e shëndetit në Evropë. (Situata e Besimit të Vaksinat, Bashkimi Evropian 2018). Megjithatë, në një studim të kohëve të fundit, Komisioni Evropian konstatoi se besimi të vaksinat është rritur në përgjithësi që prej vitit 2018, me përjashtim të vendeve, si Greqia, Rumania, Hungaria dhe Mbretëria e Bashkuar (Bashkimi Evropian, 2020). Shumë vende janë përballur me kriza të konsiderueshme besimi gjatë 20 viteve të fundit, që kanë sjellë përhapjen e sëmundjeve të rëndësishme në ditët e sotme.

Vendet e Evropës Lindore kanë një të shkuar të përbashkët qeverisjeje komuniste, që u ka dhënë formë programeve përkatëse të vaksinimit, shpesh të detyrueshme. Duke qenë se hezitimi ndaj vaksinave ndryshon sipas kontekstit, kohës, vendit dhe vaksinës, nevojitet që kërkimet të zgjerohen për të identifikuar faktorët ndikues jo vetëm në nivelin individual, por edhe në atë komunitar, kontekstual (politik, komunikimi, social, etj.) dhe në nivelin organizativ lidhur me çështjet specifike që kanë të bëjnë me vaksinat. Njohuritë, sjelljet dhe qëndrimet e punonjësve të kujdesit shëndetësor (PKSH) ndaj vaksinimit mund të ndikojnë proceset vendimmarrëse të pacientëve. Personeli i keqinformuar mund të bëhet pengesë për arritjen e mbulimit të lartë të vaksinimit në një popullatë të caktuar: shpesh, besimi i pacientëve tek ofruesit e shërbimit shëndetësor lidhet me vendimin e tyre për pranimin ose refuzimin e vaksinës.



Megjithëse Shqipëria ka pasur përqindje të larta imunizimi për të gjitha vaksinat e përfshira në kalendarin e vaksinimit të detyrueshëm (OBSH dhe UNICEF, 2021), studimet cilësore dhe sasore për pengesat publike ndaj imunizimit në Shqipëri vijojnë të mungojnë. Shqetësimi po rritet pasi hezitimi ndaj vaksinave mund të bëhet problem për vaksinat e reja ose të krijuara së fundmi, si vaksinat kundër Covid-19-ës. Besimi të vaksinat mund të konsiderohet tregues i besueshmërisë së sistemit shëndetësor dhe i besimit të publikut te qeveria. Objektivat kryesore të këtij studimi janë:

- Vlerësimi i qëndrimeve, sjelljeve, njohurive, hezitimit, besimit dhe perceptimeve të një kampioni prindërisht/kujdestarësh që ndjekin shërbimet e vaksinimit të fëmijëve në Shqipëri.
- Përshkrimi i njohurive, qëndrimeve, praktikave dhe besimeve rreth vaksinave të fëmijërisë në një kampion profesionistësh të shëndetit (mjekë dhe infermierë) të përfshirë drejtpërdrejt në administrimin e vaksinave në Shqipëri.
- Hulumtimi i nevojave për edukim dhe informacion të saktë, si dhe marrëdhënies dhe komunikimit ndërmjet prindërve dhe figurave të profesionistëve të shëndetit publik, për të krahasuar hezitimin e prindërve.

2. MATERIALET DHE METODAT

Metoda e mbledhjes së të dhënave

Për këtë studim kemi përdorur dy pyetësorë të standardizuar dhe të verifikuar, që duhet të plotësoheshin nga subjektet. Pyetësorët ishin të disponueshëm në formë fizike dhe elektronike.

Stafi i mbledhjes së të dhënave i intervistoi prindërit në qendrat e kujdesit shëndetësor duke përdorur pyetësorin e posaçëm për

prindërit. Ndërkohë, profesionistët e kujdesit shëndetësor i plotësuan pyetësorët përkatës në mënyrë individuale. Kartela individuale e vaksinimit të çdo fëmije ofroi informacion shtesë. Kartela ndihmoi përcaktimin e mbulimit të vaksinimit të fëmijëve dhe të zbatimit të programit të imunizimit.

Për qëllime studimi me prindërit/kujdestarët, u përdor një pyetësor i standardizuar që u përshtat dhe u përkthye në gjuhën shqipe. Ky instrument u krijua posaçërisht për të identifikuar prindërit hezitues ndaj vaksinës (PHV) dhe synoi të mblidhte informacion për faktorët socialë, ekonomikë dhe/ose mjedisorë, si përcaktues të sjelljes shëndetësore. Pyetësori origjinal, i përbërë nga 44 pyetje të ndara në 6 fusha, është përshtatur me kontekstin social dhe të jetesës në Shqipëri. Këtij pyetësori i janë shtuar pesë pyetje, që synojnë të vlerësojnë ndikimin e pandemisë Covid-19 te vaksinimi i fëmijëve. Së fundi, ai u përkthye në gjuhën shqipe dhe u zhvillua një testim pilot me një grup prindërisht për të matur të kuptuarit e përmbajtjes prej prindërve dhe kohën e nevojshme për plotësimin e pyetësorit, që ishte 5-7 minuta.

Ndërsa, për sa i përket studimit me profesionistët e shëndetit, është përdorur një tjetër pyetësor. Me intervistuesit u zhvillua një trajnim formues përpara mbledhjes së të dhënave. Subjekteve të përfshira iu shpërnda një fletë informuese ku garantohej konfidencialiteti i të dhënave. Pyetësori përbëhej nga tre seksione. Seksioni i parë kishte të bënte me të dhënat demografike. Seksioni i dytë përbëhej kryesisht nga pyetje të mbyllura, që synonin mbledhjen e informacionit rreth bindjeve dhe qëndrimeve të Stafit Shëndetësor lidhur me vaksinimin. Seksioni i tretë synonte vlerësimin e njohurive lidhur me kundërindikacionet e vaksinave pediatrike.

Mbulimi Gjeografik dhe Përzgjedhja e Kampionit

Për këtë studim u përzgjedhën 500 prindër dhe 100 infermierë/pediatër nga shtatë qytete të ndryshme të Shqipërisë: Tiranë, Elbasan, Durrës, Vlorë, Krujë, Lezhë dhe Shkodër. Kjo madhësi kampioni bëri të mundur gjetjen e diferencave dhe ngjashmërive të mundshme lidhur me perceptimet dhe njohuritë rreth vaksinimit në zonat me mbulim të lartë/ulët vaksinimi dhe grupe të ndryshme të shënjestruara. Njësia e kampionit ishte prindi (zakonisht nëna)/kujdestari i fëmijëve të moshës 6 muaj deri në 5 vjeç, pasi kjo është periudha më e shpeshtë e rekomanduar për kryerjen e vaksinimit. Për secilin çift (primd-fëmijë), fëmija do të kontribuojë përmes kartelës së vaksinimit, ndërsa nëna e fëmijës përmes plotësimit të pyetësorit për njohuritë dhe qëndrimin e prindit ndaj vaksinave. Kampioni është përlllogaritur me qëllim sigurimin e një fuqie jo më pak se 80% dhe sinjifikance jo më pak se 95%.

Personat e pyetur u përzgjedhën në mënyrë rastësore, duke përfshirë ata që ishin të pranishëm në qendrën shëndetësore ditën e intervistimit.

Analiza e të dhënave

Analiza statistikore e të dhënave u krye përmes paketës Statistikore SPSS (Paketa Statistikore për Studimet në Shkencat Sociale). Të dhënat u koduan dhe u analizuan nëpërmjet një qasjeje analizuese tematike induktive dhe deduktive. Personat e pyetur u kategorizuan në dy grupe, në varësi të nivelit të përgjithshëm të besimit të vaksinat sipas fushave të ndryshme të besimit në to.

Besim i lartë: Individit ka besim të lartë nëse bie dakord (“shumë dakord” ose “prirem të bie dakord”) me të gjitha pikat e përfshira në pyetësorin për besimin të vaksinat.

Disi/pak besim: Individit ka disi ose pak besim nëse nuk bie dakord me të gjitha pikat e përfshira në pyetësorin për besimin të vaksinat.

3. REZULTATET E PËRFTUARA NGA STUDIMI

- Karakteristikat demografike: Tirana ishte qyteti me pjesëmarrjen më të madhe të të intervistuarve, me 38.1% të prindërve pjesëmarrës në studim. Qyteti i dytë me pjesëmarrje më të madhe të të intervistuarve ishte Elbasani, me rreth 15%, i ndjekur nga Durrësi (~13%), Shkodra (~11%), Lezha (~10%), Vlora (~10%) dhe Kruja (5%). Shumica e prindërve i përkisnin grupmoshës 24-35 vjeç (45.9%), të ndjekur nga ata mbi moshën 35 vjeçare (40%). Vetëm dy prej prindërve ishin 18 vjeç. Shumica e personave të intervistuar ishin nëna (91%). Në katër nga intervistat nuk ishte, as nëna, as babai, por kujdestari.

Gjithsej, u intervistuan 101 profesionistë të kujdesit shëndetësor. Shumica e ofruesve të shërbimit shëndetësor të intervistuar ishin gra (89/101, 88,1%). 81.1% (n=37) mjeke dhe 92.2% (n=64) ishin infermiere. Shumica prej tyre e ushtronin profesionin në Tiranë.

Arsimi dhe Profesioni

Prindërit: Shumica e prindërve të pyetur ishin të diplomuar në universitet (~49%). Disa prej tyre kishin përfunduar edhe studimet pasuniversitare (~10%). Vetëm dy nga personat e intervistuar ishin analfabetë. Punonjësit e Kujdesit Shëndetësor: 47.5% e tyre i kishin përfunduar studimet universitare brenda 20 viteve të fundit, ndërsa 13,9% e tyre ishin diplomuar mbi 20 vjet më parë.

- Statusi social dhe informacioni mbi të ardhurat:

Prindërit: Në shumicën e intervistave, babai nuk ishte emigrant. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm ishin emigrantë (16,8%). Norma e papunësisë ishte gjithashtu e lartë (~ 31%). Vetëm 73.9% e familjeve jetonin në një shtëpi në pronësi të tyre. Shumica e familjeve kishin vetëm një fëmijë (42,5%), të ndjekur nga familjet me dy fëmijë (40,2%) dhe më pas nga familjet me 3 fëmijë (15,6%).

- Vonesa e vaksinimit: Për sa u përket vonesave të vaksinimit, kampioni përfaqësohej nga një vlerë mesatare prej 3.9 muajsh \pm 2.9 vonesë, duke variuar nga minimumi 1 muaj deri në maksimumi 24 muaj. Nëse marrim parasysh kampionin gjithsej, përqindja e fëmijëve me vaksinim të vonuar ishte 31.2% (n=148). Për sa i përket shpërndarjes gjeografike, Durrësi kishte përqindjen më të lartë të vonesave të vaksinimit të fëmijëve (48.3%); në Tiranë gjendet shumica e fëmijëve me vonesë vaksinimi (n=49). Këto rezultate paraprake kërkojnë shqyrtim të mëtejshëm për të përcaktuar arsyet e shkallës së lartë të vonesës së vaksinimit në këtë zonë, të cilat mund të jenë dhe shkaqet që sjellin këto diferenca gjeografike dhe nëse kjo lidhet me vetë shërbimin.

- Besimi i prindërve të vaksinimit: Kur prindërit u pyetën lidhur me besimin e tyre për të zbatuar rregullisht kalendarin e vaksinimit, 82% e tyre ishin plotësisht të sigurt se zbatimi i kalendarit ishte një ide e mirë për fëmijët e tyre. Megjithatë, 1.9% e kampionit ishin plotësisht të pasigurt për këtë gjë. Mbi 86% e personave të pyetur raportuan se nuk e kishin vonuar vaksinimin për asnjë arsye veç sëmundjeve dhe alergjisë. Kjo përgjigje tregon se prindërit shqiptarë kanë besim të konsiderueshëm të vaksina dhe këto rezultate janë më të mira se ato në një Studim evropian të kohëve të fundit (Hadjipanayis et al. 2020), ku 80% e prindërve raportuan se nuk e kishin vonuar vaksinimin.
- Qëndrimet e prindërve: Rreth 70% e prindërve ishin shumë dakord me shprehjen “Është përgjegjësi e prindit të vaksinosh fëmijën e vet”. 26.9% ishin dakord me shprehjen, ndërsa 2.3% ishin të pavendosur. Vetëm njëri prej tyre nuk ishte dakord me të. Kjo përgjigje tregoi se besimi i prindërve shqiptarë të vaksinimit të fëmijëve ishte shumë i lartë. Shumica e prindërve (rreth 95%) u përgjigjën se do ta vaksinonin fëmijën e dytë, çka konfirmon besimin ndaj vaksinave. Megjithatë, 19 prej tyre (3.7%) iu përgjigjën pyetjes me JO.



- **Hezitimi:** Pyetjes “sa hezitues jeni për vaksinimin”, një numër goxha i lartë i personash (46.3%) u përgjigjën se nuk ishin aspak hezitues, dhe 32% nuk janë hezitues. Nga ana tjetër, një numër i vogël i personash u përgjigjën se janë shumë hezitues (4.8%) ose disi hezitues (12%). Në kampionin tonë, përqindja e personave disi hezitues (12%) ishte më e ulët se sa në vendet evropiane në përgjithësi (24%), ndërsa të dhënat specifike për vende të ndryshme nuk ishin të disponueshme. Këto rezultate konfirmojnë besimin e prindërve të programi i vaksinimit.

- **Besimi i prindërve në informacionin mjekësor:** Lidhur me “besimin në informacionin mjekësor” dhe “përgjegjësinë e prindërve” u zhvillua një analizë statistikore e riskut të hezitimit. Rezultatet treguan një risk shumë të lartë hezitimi (OR 5.35) kur prindërit u përgjigjën me “JO” ose ishin të pavendosur për pyetjen “Është detyra ime si prind ta vaksinosh fëmijën tim?”. Risku i dytë i lartë domethënës i hezitimit (OR 2.1) u konstatua kur prindërit u përgjigjën se nuk kishin besim ose kishin besim të pakët tek informacioni i dhënë nga stafi shëndetësor mjekësor. Ky rezultat përqendrohet në ndikimin kryesor të ofruesve të kujdesit shëndetësor të hezitimi prindëror dhe kërkon hulumtim të mëtejshëm specifik.

- **Besimi në efikasitetin, sigurinë dhe besueshmërinë e vaksinave**

Përqindja e prindërve shqiptarë që nuk bien aspak dakord/nuk bien dakord me përgjigjen “është më mirë që fëmija të imunizohet nëpërmjet sëmundjes sesa vaksinës” ishte më e ulët krahasuar me rezultatet e Studimit Evropian në Shkallë të Gjerë të vitit 2020 (38% kundrejt 70%).

Përqindja shqiptare e “shumë i/e shqetësuar” dhe “i/e shqetësuar” rreth pasigurisë së vaksinave ishte më e lartë se sa rezultatet

e Studimit Evropian në Shkallë të Gjerë të vitit 2020 (57% kundrejt 7%). Këto rezultate konfirmojnë se nënat shqiptare hasin vështirësi kulturore në të kuptuarit të temës dhe u nevojitet më tepër informacion dhe diskutim me stafin shëndetësor rreth sigurisë së vaksinave. Në këtë rast, është mirë t’i sugjerohet stafit shëndetësor që t’u shpjegojë nënave domethënien e rasteve të pasigurisë dhe atyre të padëshiruara, në rast se nuk arrijnë ta kuptojnë plotësisht çështjen. Duhet të rikujtojmë se të gjithë këta prindër i çuan fëmijët e tyre për vaksinimin rutinë. 26.3% e prindërve ishin shumë të shqetësuar lidhur me efikasitetin e vaksinave. Këto rezultate konfirmuan se prindërve shqiptarë u nevojitet më tepër informacion i saktë rreth rrezikshmërisë së sëmundjeve që parandalohen nga vaksina. Në fakt, ata janë të shqetësuar, por nuk refuzojnë vaksinimin. Shumica e personave të pyetur kishin frikë për reaksione nga vaksina, por jo për ngjarje të padëshiruara madhore. Prindërve u nevojitet më tepër informacion dhe komunikim më i mirë me stafin shëndetësor.

- **Besimi te mjeku i familjes:** Rreth 87% e personave të pyetur kishin një nivel të konsiderueshëm besimi te mjeku i tyre (9 dhe 10 pikë), nga të cilët 6% e vlerësuan nivelin e besimit me 8 nga 10 pikë. Ky rezultat konfirmon ekzistencën e një marrëdhënieje të mirë dhe besimi te ofruesit e kujdesit parësor.

- **COVID-19-a dhe vaksinimi**

Në shumicën e rasteve (72%), pandemia Covid-19 nuk i ka ndryshuar perceptimet e prindërve për vaksinimin. Bazuar në shkallën e lartë të hezitimit të shfaqur ndaj kësaj vaccine të re në mbarë botën, vetëm 23.8% e prindërve ishin të gatshëm t’i vaksinonin fëmijët e tyre me vaksinë anti-Covid-19 nëse do të ishte e disponueshme. Këto të dhëna duhet të përditësohen, por shërbejnë për konsideratat paraprake, pasi studimi u zhvillua gjatë fazës së dytë të pandemisë dhe përpara fushatës së vaksinimit.

- Trajnimi Profesional: vetëm 66% e Stafit Shëndetësor raportuan se kishin ndjekur konferenca ose kurse për Vaksinat në 5 vitet e fundit, përkatësisht 65% e mjekëve dhe 65% e infermierëve. Pjesëmarrja në konferencat dhe kurset për vaksinat luan një rol të rëndësishëm në 80% të PKSH-ve.
- Mjetet e trajnimit dhe ndikimi i tyre: Diploma e universitetit është një element me rëndësi për shumicën e PKSH-ve. Faqet institucionale në internet rezultojnë të parëndësishme. Formimi universitar luan një rol të rëndësishëm për 77% të PKSH-ve (shumë dakord dhe dakord) rreth njohurive për sëmundjet infektive të parandalueshme nga vaksinat. Roli i diskutimit rreth vaksinimit me kolegët është shumë i rëndësishëm dhe ndikon 82% të PKSH-ve. Roli i kurseve trajnuese pati ndikim për 70% të PKSH-ve (shumë dakord dhe dakord). Ekzistojnë diferenca statistikisht domethënëse ndërmjet rolit të Literaturave Shkencore dhe Faqeve institucionale të internetit, ku të dyja kishin shkallën më të lartë të ndikimit për mjekët krahasuar me infermierët.
- Besimet, qëndrimet dhe hezitimi i PKSH-ve ndaj vaksinave: Punonjësit e kujdesit shëndetësor shfaqën një përqindje të lartë (90%) të besimit të vaksinimit. Fjalisë “Vaksinat janë ndër produktet mjekësore më të sigurt dhe më të testuara”, 32% e mjekëve dhe 22% e infermierëve iu përgjigjën me “jo i/e sigurt”. Fjalisë “Çrregullimet si autizmi dhe sëmundjet si skleroza multiple mund të shkaktohen nga vaksinat”, 30% e mjekëve dhe 22% e infermierëve iu përgjigjën me “jo i/e sigurt” (i/e pavendosur ose pjesërisht dakord/dakord).
- Njohuritë e PKSH-ve lidhur me kundëringdikacionet e vaksinave: Asnjëri nga PKSH-të nuk arriti të identifikonte saktë të 10-të kundëringdikacionet e

vërteta dhe të gabuara të vaksinës hegzivalente (difteria, tetanozi, kolla e mirë, poliomieliti, influenza hemofile tipi B, hepatiti B). Ndërmjet Infermierëve dhe Mjekëve u konstatua një diferencë më e lartë dhe statistikisht domethënëse (3,8594 kundrejt 5,4595 $p < 0,001$) lidhur me njohuritë e tyre rreth kundëringdikacioneve të vërteta ose të gabuara. Nuk u konstatua asnjë diferencë domethënëse në lidhje me gjininë. 69% e PKSH-ve që iu përgjigjën saktë të paktën gjashtë pyetjeve ishin mbi moshën 64 vjeç.

4. PËRFUNDIME

Shumica e prindërve shqiptarë beson te rëndësia e vaksinimit në fëmijëri dhe e konsideron vaksinimin e fëmijës si pjesë të rolit të tyre si prindër. Prindërit shqiptarë raportuan siguri dhe besim të stafi shëndetësor dhe ofruesit e kujdesit parësor. Ata shfaqën shqetësim normal rreth shëndetit të fëmijës, ngjarjeve të padëshiruara dhe sigurisë së vaksinave, gjë që tregon nevojën e tyre për informacion, edukim dhe komunikim më të mirë. Studimi identifikoi një lidhje domethënëse ndërmjet hezitimit të prindërve dhe besimit tek informacioni për vaksinat nga stafi shëndetësor. Ky rezultat vë në dukje nevojën për komunikim më efikas dhe gjithëpërfshirës ndërmjet prindërve dhe stafit mjekësor.

Stafi i shërbimeve të vaksinimit në Shqipëri paraqet një nivel relativisht të ulët njohurish, veçanërisht lidhur me kundëringdikacionet dhe indikacionet për vaksinat në fëmijërinë e hershme, ku mjekët kanë njohuri shumë më të mëdha se sa infermierët. Krahasimi me pediatri italianë tregon se njohuria e pediatërve shqiptarë është shumë më e ulët. Nuk është e mundur të përcaktohet ndikimi pozitiv për njohuritë e trajnimeve të konceptuara si trajnime, kurse ose në forma të tjera. Ndryshimi i vetëm është në rol dhe më pas në diplomimin universitar.

5. REKOMANDIMET

- Zhvillimi i programeve të trajnimit për komunikimin ndërmjet punonjësve të kujdesit shëndetësor dhe prindërve. Megjithëse prindërit e përdorin internetin për të marrë informacion rreth vaksinimit, mjekët vijnë të jenë burimi më i besuar i informacionit. Ndërtimi i besimit me prindërit është një mision kompleks, që varet nga statusi i tyre kulturor, ekonomik, dhe social. Prandaj, duhet të krijohen programe profesionale dhe të posaçme për të trajtuar shqetësimet e prindërve rreth vaksinimit.
- Zhvillimi i programeve të trajnimit para lindjes për gratë shtatzëna me gjuhë të kuptueshme.
- Zhvillimi i programeve ndërgjegjësuese për publikun, duke u fokusuar tek angazhimi i liderve me ndikim, për të promovuar vaksinimin në komunitet.
- Përfshirja e mediave për shpërndarjen e mesazheve ndërgjegjësuese rreth vaksinimit.
- Bashkëpunimi me grupet e shoqërisë civile për të promovuar vaksinimin dhe shfrytëzimi i burimeve publike për të rritur ndërgjegjësimin.
- Zhvillimi i projekteve për të nxitur pjesëmarrjen e më shumë grupeve të shënjestruara në çështjen e vaksinimit.
- Hartimi i një plani për të matur dhe trajtuar hezitimin ndaj vaksinave në Programin e Imunizimit.
- Integrimi i informacionit rreth vaksinave në arsimin e mesëm të lartë.
- Kryerja e studimeve epidemiologjike për të vlerësuar karakteristikat e grupeve hezituese dhe për të trajtuar hezitimin.
- Hartimi i planeve të rrezikut të komunikimit për publikun kurdo që përhapen informacione të rreme rreth vaksinimit.
- Integrimi ose zgjerimi i hapësirës së dedikuar për programet edukuese të lidhura me vaksinimin në Studimet Universitare. Edukimi i individëve të rinj në moshë rreth vaksinave mund të formësojë besimet dhe sjelljet e ardhshme ndaj vaksinave.
- Zhvillimi i programeve të edukimit në vazhdim lidhur me vaksinimin.
- Zhvillimi i programeve të trajnimit të përshtatura sipas kontekstit dhe profesionit, me gjuhë gjithëpërfshirëse.
- Zhvillimi i programeve ndërgjegjësuese për profesionistët dhe publikun.
- Integrimi i informacionit rreth vaksinimit në provimet profesionale të nevojshme për certifikimin e punonjësve të kujdesit shëndetësor.



Deklaratë për mospranim përgjegjësie

Ky dokument mbështetet tek Hezitimi ndaj vaksinave i prindërve apo kujdestarëve në Shqipëri: Njohuritë, qëndrimet dhe praktikat ndaj vaksinimit në fëmijëri, të kryer nga Enkeleda Gjini. Zhvillimi i studimit dhe hartimi i dokumentit është mbështetur nga Projekti Shëndet për të Gjithë i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i zbatuar nga Instituti Zviceran i Shëndetit Publik dhe Mjekësisë Tropikale (STPH).

Opinionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë publikim janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të SDC, STPH apo HAP.

**Një projekt i Agjencisë Zvicerane
për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC**



Implementuar nga

Swiss TPH

Swiss Tropical and Public Health Institute

